P R O Ç E S V E R B A L

Nga seanca e këshillit të mbajtur me 15.03.2023, e martë me fillim në ora 10:00, në sallën e këshillit të komunës së Zhelinës, në prezencë të këshilltarëve dhe të Kryetarit të komunës Blerim Sejdiu.

Seancën e 17-të, (shtatëmbëdhjetë) e hapi Kryetari i këshillit Bujar Baftijari, dhe prezantoi propozimin e rendit të ditës me nr. Arkivor 08-402/1 në përbërje prej tre pikave.

R E N D D I T E

1. Miratimi i proçesverbalit të seancës së 16-të, të Këshillit të komunës së Zhelinës.
2. Miratimi i Llogarisë përfundimtare të Buxhetit të komunës së Zhelinës për vitin 2022-të.
3. Shqyrtimi i Kërkesës nr. 21-326/1 i datës 28.02.2023 nga Muhamed Alija nga f.Llërcë.

Pas prezantimit të rendit të ditës Kryetari i këshillit Bujar Baftijari hapi diskutim për rendin e ditës. Fjalën e mori këshilltarja Lejla Hajdari.
Lelja H: Kërkoj që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë edhe atë shqyrtimi i kërkesë nr. 08-297/1 i datës 23.02.2023 nga Bashkësia lokale e fsh. Strimnicë.
Pas këshilltares Lejla Hajdari fjalën e mori këshilltari Bashkim Limani.
Bashkim L: Propozoj që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy kërkesat edhe atë, Propozim-Vendimi për pastrimin dhe menjaninmin e mbeturinave inerte në objektin e shkollës fillore të fshatit Pallaticë dhe Propozim- Vendim për prishjen e objektit të vjetër të shkollës periferike të fshatit Cerovë.
Pas këshilltarit Bashkim Limani fjalën e mori këshilltari Naser Mislimi.
Naser M: Kërkoj sqarime nga juristët e komunës se si mund kjo kërkes të paraqitet përsëri në rend dite.
Kryetari i këshillit propozimin e këshilltares Lejla H. E hodhi në votim ku me 10 vota për, 8 kundër dhe asnjë të përmbajtur konsatoi se kjo kërkesë i shtohet rendit të ditës.
Vazhdoi me hudhje në votim të dy kërkesave të këshilltarit Bashkim Limani, ku u votuan unanimisht.
Më pas Kryetari i këshillit rendit e ditës e hodhi në votim, u votua unanimisht. Pas kësaj e shpalli të hapur seancën e 17-të.

1. Miratimi i proçesverbalit të seancës së 16-të, të Këshillit të komunës së Zhelinës.

   Nuk pati diskutim dhe këtë pikë Kryetari i këshillit e hodhi në votim, u votua unanimisht.

2. Miratimi i Llogarisë përfundimtare të Buxhetit të komunës së Zhelinës për vitin 2022-të.

Kryetari i këshillit Bujar Baftijari hapi diskutim. Fjalën e mori këshilltari Sheval Sulejmani.
Sheval S: Në disa zëra kam dilema për mënyrën se si janë realizuar këto mjete. Janë disa zëra financiar në të cilët parashihen disa vlera të cilat edhe më herët i kemi parë.
Te zëri finnaciar për planifikim urbanisitik kemi disa shuma të paraqitura te buxheti dhe te realizimi, kërkoj më shumë informacione rreth kësaj?
Pastaj te zërat për ndriçim publik kemi një shumë, për të cilën kërkoj poashtu informacione ?
Poashtu kemi edhe higjiena publike edhe për mjete financiare të këtij zëri dua informacione?
Informacione edhe për ndërtimin e ndriçimit publike kërkoj?
Informatat për dilemat e këshilltarit Sheval Sulejmani i dha Adil Emini nga sektori për çështje financiare.
Më pas fjalën e mori këshilltari Naser Mislimi.
Naser M:higjena publike a është kompetenc e komunës apo ndërmarrjes? Edhe informacione për sport dhe rekreacion? Edhe te ky zëri objekte ndërtimore nga arsimi edhe këtu të jepen info më tepër?
Informata për këshilltarin Naser, i dha Adil Emini nga sektori për çështje financiare.
Pas diskutimeve kryetari i këshillit këtë pikë e hodhi në votim ku me, 11 vota për, 7 të përmbajtur dhe asnjë kundër konstatoi se kalon.

3. Shqyrtimi i Kërkesës nr. 21-326/1 i datës 28.02.2023 nga Muhamed Alija nga f.Llërcë.

Në këtë pikë këshilltari Ajredin Sadiki e mori fjalën.
Ajredin S: Për këtë rast unë propozoj një shumë prej 15 000 denarësh.
Propozimin e këshilltarit Ajredin kryetari i këshillit e hodhi në votim, ku me 17 vota për, 1 të përmbajtur dhe asnjë kundër konstatoi se kërkesa miratohet.

4. Shqyrtimi i Kërkesës nr.08-297/1 i datës 23.02.2023-të, nga Bashkësia lokale e f.Stremnicë

Kryetari i këshillit hapi diskutim për këtë pike. Fjalën e mori këshilltari Naser Mislimi.
Naser M: Për këtë kërkesën kërkoj nga admistrata që merren dikush me këto çështje të më jap informacione sepse për mua kjo kërkesë e njëjta si në këshillin e më parshëm nuk ka logjikë të përsëritet.
Informacione për këshilltarin Naser Mislimi i dha Shefije Saiti nga Seksioni për punë normative-juridike dhe punë të përgjithëshme administrative.
Pas diskutimeve Kryetari i këshillit kërkesën e hodhi në votim ke me 13 vota për, 2 kundër dhe 3 të përmbajtur konstatoi se kjo kërkesë miratohet.

5. Propozim – Vendim për pastramin dhe menjanimin e mbeturinave inerte nga objekti i vjetër i shkollës në f. Pallaicë.

   Meqë nuk pati diskutim Kryetari I këshillit këtë kërkesë e hodhi në votim, u votua unanimisht, me këtë konstatoi se kjo kërkesë miratohet.

6. Propozim – Vendim për prishjen e objektit të vjetër të shkollës periferike të f. Cerovë.

Edhe te kjo kërkesë nuk pati diskutim, dhe Kryetari i këshillit e hodhi në votim, ku u votua unanimisht dhe konsatoi se kjo kërkesë miratohet.

Kryetari i këshillit Bujar Baftijari e konstatoi të mbyllur seancën e 17- të (shtatëmbëdhjetë)

Nr.08-402/2
15.03.2023-të
Zhelinë

Procesverbalist
Albineta Alija

Këshilli i komunës së Zhelinës
Kryetar
Bujar Baftijari